

ABSM, sinonim për integrimin e suksesshëm në Zvicër

Reklamë _____

05.07.2012 - 08:57

Për shqiptarët, ABSM për 15 vjet ka qenë një pikë referimi për aktivitete kulturore, mbështetje të aftësimit profesional jo vetëm në Zvicër



PUNËSIM PAS DIPLOIMIT

Reklamë _____

Të udhëheqësh si i huaj në Zvicër për 15 vjet një organizatë jo fitimprurëse nuk është gjë e lehtë. Këtë e di shumë mirë Skënder Nikoliqi, gjakovari nga Bazeli, i cili sikurse për çdo vit, për të 15-ën herë është përballur me sfidën se si të sigurojë mbijetesën e ABSM-së, gendrës të cilën e ka sjellë në jetë ai me një grup të vogël bashkëpunëtorësh.

ABSM është shkurtesë në gjermanishtë për Qendrën për Aftësim Profesional dhe Këshillim të Migrantëve. Si e tillë, kjo qendër është sinonim për integrimin, arsimimin dhe kualifikimin e të huajve, që i kalon kufijtë e Bazilit, ku e ka selinë.

Ndërsa për shqiptarët, që nga themelimi i saj, ABSM ka qenë një pikë referimi për aktivitete kulturore, mbështetje të aftësimit profesional jo vetëm në Zvicër. Ajo udhëheq edhe në Kosovë, një qendër të tillë. ABSG (G është për Gjakovë) siç quhet qendra, është hapur në vitin 2000, dhe ajo bën ndërlidhjen në mes të arsimimit shkollor dhe jetës profesionale.

Nikoliqi pranon se po bëhet gjithnjë më e vështirë të drejtohet një themelatë e tillë. Dhe kjo në radhë të parë për shkak të vështirësive për të siguruar fonde. Por megjithatë, besimi i krijuar gjatë gjithë këtyre viteve te fondacionet e ndryshme në kanton dhe jashtë tij e bën të veten.

Kliko këtu për tu informuar më shumë!



Fëmijët shpalosin talentin e tyre në pikturë dhe muzikë

Në QSHKI, Kreuzlingen hapet ekspozita e piktores së vogël Abetare Berila dhe mbahet takimi garues i instrumentistëve të vegjël dhe të rinj



Diaspora shqiptare, në fokus të Institutit Albanologjik të Kosovës

Tre studiues të rinj shkencorë të Institutit Albanologjik të Kosovës po qëndrojnë këto ditë për një vizitë pune në Zvicër

Gjatë javës së kaluar ABSM ka organizuar dy aktivitete; turnirin në futboll, në bashkorganizim me FC "Dardania" dhe ndarjen e diplomave ndjekësve të kurseve njëvjeçare që i udhëheq kjo qendër në Basel.

Përfundimi i vinit shkollor 2011-2012 u shënua nën qiellin e hapur, në një kopsht të bukur në qytetin e Bazelit, ku krahas ndarjes së diplomave pati edhe një program artistik dhe kulinarik.

Grupi muzikor "Kapsamun" që kultivon muzikë shqiptare në fryshtë e xhazit u kujdes për atmosferën e relaksuar në këtë takim të cilit ia shtoi sharmin me kombinimin mbresëlënës të disa stileve muzikore.

Të pranishëm në këtë manifestim ishin edhe Christoph Marbach, përgjegjës për këshillime profesionale dhe arsimim të rriturve në kantonin Baselstadt si dhe Antonella della Roca nga qendra profesionale për arsimimin e rriturve. Këta të dy ua dorëzuan diplomat të gjithë kursistëve dhe përcollën përgëzimet e institucioneve përkatëse për punën e frytshme të ABSM-së. Një fjalë përvihendjeje dhe një prezantim të ABSM-së ka bërë Nazmi Jakurti në emrin e kryesisë së kësaj qendre.

Ndërkaq, siç na thotë Skënder Nikoliqi, kurset që ofron ABSM, me emrat si: "Konkret", "Aspecta", "Takimi" dhe kurset e kompjuterizimit, gjatë këtyre 15 viteve janë ndjekur nga më shumë se 3500 veta. "Në ABSM u mundësojmë të interesuarve me mundësi modeste financiare të ndjekin kurse me bazë solide me një çmim simbolik", thotë Nikoliqi. Ai me këtë rast ka parasysh çmimet që janë të pakrahasueshme me ato të kurseve tjera në qytet.

"Te ne mësohet gjuha gjermane nga kategoria A deri në B2 ndërsa kemi hapur edhe kursin me emrin "Takimi" që u dedikohet grave shqiptare të cilat kanë ardhur rishtaz në Zvicër ose që kanë jetuar këtu por u kanë munguar kontaktet me gjuhën gjermane. Në këtë kurs, krahas mësimit të gjuhës, kursisteve u ofrohet edhe përkudjesja përfëmijët gjatë kohës sa ato ndjekin kursin.

Aktivitet tjetër i ABSM-së, kësaj here në bashkëpunim me Klubin Futballistik "Dardania", ka qenë tuniri "Sporti flet një gjuhë" i mbajtur më 24 qershor në stadiumin Bachgraben-Allschwill. Në emrin e organizatorëve, aktivitetin e ka shpallur të hapur Besim Pajaziti.

24 ekipe të paraqitura, që kishin ardhur nga pjesë të ndryshme të Zvicrës por edhe nga zonat kufitare të Gjermanisë dhe Francës, kanë zhvilluar një garë mjaft të fortë. Në fund, fitues ka dalë ekipi "Fahrsschule Fundrive". Vendin e dytë e ka zënë ekipi "Gjakova", të tretin "H. Badalli GmbH" dhe të katërtin, "Bajazzo".

Për rëndësinë që këtij turniri ia kushtojnë autoritetet e këtushme, dëshmon prania në të e udhëheqësit për zhvillim të qytetit dhe të kantonit Basel-Stadt, Thomas Kessler. Ishte po ashtu i pranishëm edhe përgjegjësi për integrim në Federatën e Futbollit të Zvicrës veriperëndimore, Hasan Kanber.

Kessler në fjalën e tij të hapjes ka thënë se "sporti si aktivitet që kalon kufijtë e përkatësive kulturore, është mundësia më e mirë e takimit në mes të vendësve dhe popullatës me prejardhje të huaj. Ai është në gjendje të ngrëjë ura dhe të rrëzojë paragjykime".


Para pjesëmarrësve të shumtë në këtë turnir u prezantuan edhe dy futbollistë profesionistë shqiptarë, Muhamed Demiri nga FC Thun dhe Sehar Fejzullahi nga Grasshoppers i Cyrihut. Këta të fundit shpërndanë medaljet përfëmijët, sportistë më të suksesshëm.

Krahas futbollit, në këtë ditë sportive pati edhe vrapim në 100 metra. Ndërsa Shkolla Shqiptare e Vallëzimit "Shota" ka shfaqur një porogram të pasur artistik me valle shqiptare.



Diaspora anashkalohet në projektin e Brezovicës

Ekspertri i turizmit, Zekë Çeku është i mendimit që në treg të barabartë, duhet t'i u jepet prioritet investitorëve të diasporës për procesin e privatizimit të Brezovicës



Shtypja e arsyes në nivel lokal

Zgjedhjet lokale do të duhet të janë një proces ku njerëzit të zgjedhin drejtuesit të cilët do të vihen në shërbim të problemeve të tyre në qytete dhe fshatra. Por zgjedhjet po nxisin debatet nacionaliste duke kanalizuar fushatën në ujëra të tjerë.



Si mund ta dallojmë mërzinë nga depresioni?

Migesplus.ch propozon dy doracakë për sëmundjet mendore në gjuhën shqipe



Duhani: këtë duhet ta dini

Si ndikon nikotina? Përse pi duhan rinia? A është problematik duhani?


Reklamë

Foto galeri

Blerim Shabani



Reklamë



Tri
rregulla
të artë:

- Drink or drive (Pi ose vozit): Kush vozit, nuk pil
- Planifikoni një shërbim vozitjeje «të eselt» përparrasë të fillojë kënaqësia e kohës së lire.
- Shmanguni medoemos kombinimit të alkoolit me droga të tjera ose medikamentet

Fachstelle für interkulturelle
Sozialprävention und
Gesundheitsförderung **FISP**
www.fisp-zh.ch



FACHSTELLE ASN
Fachstelle für interkulturelle
Sozialprävention und
Gesundheitsförderung **ASN**
www.fachstelle-asn.ch

Reklamë



Me mbështetjen e

Copyright © 2010 albinfo.ch. All Rights Reserved.



Përdorimi i shkrimeve, fotografive si dhe materialeve të kësaj platforme mund të bëhet vetëm duke e përmendur burimin albinfo.ch. Cdo shfrytëzim dhe riprodhim i tyre pa lejen e albinfo.ch është i ndaluar dhe përbën shkelje e të drejtave autoriale.

Redaksa e mban të drejtën për mosbotimin dhe moskthminin e dorëshkrimeve, fotografive apo materialeve të tjera të dërguara.

Rreth nesh